

LIGJ
Nr.7545, datë 6.1.1992

PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT E PERSONAV FIZIKË NË SEKTORËT PRIVATË TË TRGTISË, ARTIZANATIT E TË SHËRBIMEVE TË TJERA

Në mbështetje të neneve 13 dhe 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Personat fizikë që ushtrojnë veprimtari private në fushën e tregtisë, të artizanatit dhe të shërbimeve, si transport, shëndetësi, avokaturë, e veprimtari të kësaj natyre, i nënshtrohen tatimit mbi të ardhurat që realizojnë.

Neni 2

Tatimi llogaritet me tarifë proporcionale dhe fikse mbi të ardhurat që realizohen nga shitja ose kryerja e shërbimeve, dhe derdhen në buxhetin e shtetit në afatet e caktuara.

Neni 3

Për personat fizikë që ushtrojnë veprimtari në njësi të veçanta, zbatohen tarifa të tatimit proporcional në këtë masë:

- a) Tregtarët që shesin kryesisht prodhime të përpunuara vetë, 12 për qind.
- b) Tregtarët që shesin mallra konsumi industrial, ushqimor dhe produkte të tjera të gatshme, 10 për qind.
- c) Artizanët e shërbime të tjera publike, 7 për qind.
- ç) Avokatët, mjekët, veterinerët e persona të tjerë fizikë që ushtrojnë profesione të ngjashme me to, 20 për qind.

Neni 4

Personat fizikë që ushtrojnë veprimtari ambulante e forma të tjera të kësaj natyre, paguajnë tatim vjetor me tarifa fikse në këtë masë:

- a) Tregtarët që shesin prodhime mishi, sheqeri, brumi etj. 10.000 lekë.
- b) Tregtarët që shesin mallra konsumi ose artikuj të tjerë industrialë 8.000lekë.
- c) Për shërbimet në transport:
 - për automjetet deri në 5 vende, 12.000 lekë;
 - për automjetet deri në 10 vende, 20.000 lekë;
 - për automjetet mbi 10 vende, 35.000 lekë;
 - për mjetet e vogla detare në shërbim të pushuesve, 5.000 lekë;
 - për automjetet deri në 2 tonë, 15.000 lekë;
 - për automjetet deri në 5 tonë, 30.000 lekë;
 - për automjetet mbi 5 tonë, 50.000 lekë.
- ç) Personat fizikë që kryejnë shërbime, si lustraxhi e të tjera të kësaj natyre, 1.000 lekë.
- d) Personat që kryejnë riparime e shërbime të artikujve elektroshtëpiakë, 3.500 lekë.
- dh) Rrobaqepës, trikopunues, marangoz, murator, teneqepunues, qëndistar, prodhime të imëta artistike, bojaxhi, hidraulik, galanteri e të tjera si këto, 2.500 lekë.
- e) Mjek, veterinerë dhe persona të tjerë që ushtrojnë profesione të ngjashme me to në mënyrë

ambulante, 3000 lekë.

Neni 5

Tatimi sipas neneve 3 dhe 4 llogaritet dhe caktohet nga organet tatimore të rretheve branda muajit janar për çdo vit tatimor.

Neni 6

Tatim me tarifa proporcionale derdhet në katër këste në afatet 15 mars, 15 qershor, 15 shtator dhe 30 nëntor të çdo viti.

Tatimi mbi tarifa fiskale derdhet në mënyrë të barabartë për çdo muaj jo më vonë se data 10 e muajit pasardhës.

Neni 7

Subjektet e parashikuara në nenin 3 të këtij ligji janë të detyruara të regjistrojnë, dokumentojnë e deklarojnë me shkrim të ardhurat që realizojnë. Deklarata i jepet organeve tatimore brenda datës 15 janar të çdo viti sipas modelit të caktuar nga Ministria e Financave.

Neni 8

Quhen shkelje të këtij ligji:

- a) Fshehja e të dhënave për të ardhurat dhe pasqyrimi jo i saktë i tyre;
- b) Mosmbajtja e dokumenteve për të ardhurat;
- c) Dhënia me vonesë e deklaratës për të ardhurat.

Neni 9

Shkeljet e parashikuara në nenin 8 të këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, quhen kundërvajtje administrative dhe dënohen:

- Shkeljet e parashikuara në shkronjën "a" me gjobë 4000 lekë;
- Shkeljet e parashikuara në shkronjën "b" me gjobë 5000 lekë;
- Shkeljet e parashikuara në shkronjën "c" me gjobë 1000 lekë.

Në çdo rast tatimi nxirret 100 për qind.

Neni 10

Të drejtën e gjobës e kanë inspektorët e tatimeve në rrethe dhe punonjësit e drejtorisë së tatimeve në Ministrinë e Financave.

Kundër vendimit të dënimit mund të bëhet ankim brenda 5 ditëve nga dita e shpalljes ose e njoftimit të tij, përkatësisht te përgjegjësi i seksionit të financës a të drejtorit të drejtorisë së tatimeve, akti i të cilëve është i formës së prerë.

Neni 11

Ministria e Financave ngarkohet të nxjerrë udhëzime të hollësishme për zbatimin e këtij ligji.

Neni 12

Dispozitat që janë në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 13

Ky ligj hyn në fuqi më 10.8.1991, me hyrjen në fuqi të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 "Për

sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit".

Shpallur me dekretin nr.107, datë 11.1.1992 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ramiz Alia.